



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Tel. 038/20046037

DEPARTMENT OF CULTURE, YOUTH & SPORT

UPRAVA ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT

Adresa: "Dëshmorët e Kombit"

Nr: 47/24

Duke u bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Ferizajt dhe Klubit Letrar "De Rada" me numer portokoli 73/24 të datës 03.04.2024, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Ferizaj shpall:

## THIRRJE PUBLIKE PËR PROJEKT-PROPOZIMET PËR MBËSHTETJEN E AUTORËVE

Thirrjen publike për mbështetje të autorëve të pavarur dhe promovimin e autorëve të rinj në procesin e shtypjes së librave. Kjo iniciativë ka për qëllim të ndihmojë autorët dhe të kontribuojë në pasurimin e kulturës dhe letërsisë në Ferizaj.

### Kriteret dhe Kushtet e Aplikimit:

- Kategoritë e Mbështetjes:**
  - DKRS do të mbështesë autorët në procesin e shtypjes së veprave të tyre në të gjitha zhanret dhe fushat që i përmbushin kriteret për botim.
  - Mbështetje përfshin financimin e kostove të shtypjes dhe lidhjes së librave.
- Kush mund të aplikojë:**
  - Autorë që kanë përfunduar dhe janë të gatshëm për të shtypur një vepër.
  - Autorët duhet të jenë banorë të komunës së Ferizajt.
- Dokumentacioni i Nevojshëm:**
  - Formular aplikimi të plotësuar (disponues në zyrën e Drejtorisë ose në faqen tonë të internetit);
  - Kopje fizike dhe elektronike e veprës së finalizuar që do të shtypet (manuskripti i përfunduar);
  - Dy vlerësime me shkrim nga profesionistë të fushës përkatëse të librit;
  - CV e autorit dhe një letër motivimi që shpjegon rëndësinë dhe ndikimin e veprës.
  - Kopje e dokumentit të identifikimit.
  - Dëshmi për vendbanimin

4. **Afati i Dorëzimit:**
  - Aplikimet duhet të dorëzohen nga data: 28.08.2024-17.09.2024
5. **Procedura e Vlerësimit:**
  - Vlerësimi i aplikimeve do të bëhet nga një komision profesional i përbërë nga anëtarë të Klubit Letrar "De Rada", duke u bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Ferizajt dhe Klubit Letrar "De Rada".
  - Rezultatet e vlerësimit do të shpallen brenda një muaji pas afatit të dorëzimit.
6. **Nuk mbështeten në këtë thirrje publike:**
  - Doracakët dhe udhëzuesit.
  - Publikimet për marketing.
7. **Dorëzimi i Aplikacioneve:**
  - Aplikacionet duhet të dorëzohen në zyrën pritëse, objekti i Komunës së Ferizajt.
  - Përfituesit e kësaj thirrjeje duhet të lënë nga 5 ekzemplarë në Bibliotekën e Qytetit "Sadik Tafarshiku", 4 ekzemplarë për degët e bibliotekës në fshatra dhe 2 ekzemplarë në bibliotekën rinore në Ferizaj, dhe 5 ekzemplarë për Klubit Letrar "De Rada"

Për më shumë informacion, ju lutemi të kontaktoni:

- **Emali-Adresa:**
  - Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (xhelal.topalli@rks-gov.net)
  - Klubi Letrar "De Rada" (klubiletrarderada@hotmail.com)

Ftojme të gjithë autorët ferizajas të shfrytëzojnë këtë mundësi për të realizuar projektet e tyre dhe për të kontribuar në pasurimin e fondit librar.

**Vërejtje:** Të gjitha botimet do të shtypen nga operatori ekonomik, i kontraktuar nga Komuna e Ferizajt.

Ferizaj:

28.08.2024

